

## Titulli i lëndës: PROJEKTIM 7 – FERMAT VERTIKALE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	<b>PROJEKTIM 7 – FERMAT VERTIKALE</b>
Niveli:	master
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	Viti I / semestri I
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Arta Xhambazi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:arta.xhambazi@uni-pr.edu">arta.xhambazi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Çështjet e bujqësisë dhe impaktit të saj në mjedis janë temë e kursit i cili studion dhe hulumton gërshetimin e arkitekturës dhe agrokulturës. Kjo arrihet përmes shtjellimit të qasjeve projektuese prej tipologjisë së komplekseve agroindustriale rurale deri te edhe strukturat multifunktionale bashkëkohor urbane. Fillimisht trajtohen komplekset bujqësore rurale me veçoritë e përgjithshme, e pastaj trendet aktuale të paradigms së bujqësisë urbane si: fermat vertikale, parqet bujqësore, komplekset blegtoje, fermat urbane, kopshtet vertikale etj.. Tipologjia e detyrës semestrare të strukturave multifunktionale do të caktohen për çdo vit akademik sipas trendeve aktuale në bashkëpunim me studentët dhe referencat ndërkombëtare akademike.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kursit është afirmimi i qasjes së integruar ndërdisiplinore për të zgjidhur problemet e projektimit arkitektonik e që arrihet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– ndërlidhjes simbiotike të avancimit të teknologjisë dhe projektimit arkitektonik</li> <li>– promovimit të koncepteve të projektimit të qëndrueshëm</li> <li>– veçimit të procesit krijues artistik si një qasje për të identifikuar dhe zgjidhur sfidat bashkëkohore në zhvillimin e komunitetit dhe qytetit.</li> <li>– zhvillimit e aftësive të studentëve për të studiuar dhe kuptuar ndërlidhjen në mes projektimit arkitektonik me mirëqenien publike dhe ndotjen e mjedisit.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Interpreton nocionin e agrikulturës në kontesktin global, përmes analizës së komponentët arkitekturale në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake</li> <li>– Analizon procesin e integruar të projektimit që implikon vetëdijësim për rëndësinë e fazave të ndryshme të projektimit</li> <li>– Harton programin projektues në raport me problemin lokal të përzgjedhur</li> <li>– Arsyeton dhe integron parimet themelore projektuese të komplekseve shumëfunktionale të bujqësisë urbane si dhe asaj rurale</li> </ul>

	– Propozon zgjidhje ideore arkitektonike me të cilin demonstron aftësitë e nevojshme për projektim e objekteve bujqësore urbane ose rurale.		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.3	5	1.5
Puna në terren	4	3	12
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	0.5	3	1.5
<b>Total</b>			<b>150</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërimi ex-catedra lidhur me problemet funksionale-konstruktive, analiza të projekteve si dhe temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentët. Gjatë semestrit parashihet edhe vizitë studimore dhe punë hulumtuese në objektet bujqësore. Studenti pasi përpilon programin projektues, realizon detyrën semestrale me punë me mbikqyrje gjatë ushtrimeve si dhe punë individuale në shtëpi e terren.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Marrja e kredive bëhet me verifikimin e prezencës dhe aktivitetit në ligjërata dhe ushtrime, me projektin semestral të vlerësuar pozitivisht si dhe provimin me shkrim të vlerësuar pozitivisht. Vlerësimi përfundimtarë përbëhet 70 % nga punimi semestral dhe 30% nga provimi me shkrim.		
<b>Literatura primare:</b>	The Vertical Farm: Feeding the World in the 21st Century, Dickson Despommier, 2011 The Integrative Design Guide to Green Building: Redefining the Practice of Sustainability, 7group & Bill Reed, John Wiley & Sons, 2009 Architecture for Food, Van Bergen Kolpa Architects and Wageningen, 2018 The Vertical Farm - Architectural Design Principles, Bujar Bajçinovci, 2017 The Vertical Farm – Part 2, Architectural Design Principles, Bujar Bajçinovci, 2018 The New Farm: Contemporary Rural Architecture, Daniel P. Gregory Princeton, Architectural Press, 2020 Architecture and Agriculture: A Rural Design, Dewey Thorbeck, Routledge, 2016		

	Farm Buildings – Planning and Construction, Neil Southorn, Butterworth-Heinemann, 1997
<b>Literatura shtesë:</b>	Above the pavement – the Farm: Architecture & Agriculture, Amale Andraos & Dan Wood, Princeton Architectural Press, New York Second Nature Urban Agriculture: Designing Productive Cities, André Viljoen and Katrin Bohn eds., Routledge, 2014 Smart Plant Factory: The Next Generation Indoor Vertical Farms, Toyoki Kozai, Springer 2018 Neufert Architects' Data, Ernst Neufert & Peter Neufert, 4th ed., Wiley-Blackwell, 2012 Urbanistika dhe ndërtimet e fshatit, Enver Faja & Isuf Sutaj, 1988

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Prezantimi i syllabusit të lëndës
<i>Java 2:</i>	Hyrje në projektimin dhe ndërtimin e objekteve bujqësore. Mardhënia midis arkitekturës dhe agrikulturës.
<i>Java 3:</i>	OBORRET DHE KOMPLEKSET BUJQËSORE. Njohtimi me objektet bujqësore, kompleset dhe vecoritë e përgjithshme. Principet, komplekset dhe shembujt.
<i>Java 4:</i>	AGRIKULTURA DHE ARKITEKTURA: Dje, sot dhe nesër
<i>Java 5:</i>	FERMAT VERTIKALE: Utopi apo realitet. Teknologjia e fermave vertikale
<i>Java 6:</i>	FERMAT VERTIKALE: Analiza e rasteve studimore dhe programi projektues
<i>Java 7:</i>	FERMAT VERTIKALE: Analiza e rasteve studimore. Konceptet bashkëkohore
<i>Java 8</i>	Paradigma e fermave vertikale: Benefitet mjedisore dhe sociale. Fermat vertikale dhe funksionet tjera.
<i>Java 9:</i>	Përdorimi i tokës bujqësore
<i>Java 10:</i>	Zona e prodhimit e kompleksit bujqësor. Veçoritë dhe principet e projektimit
<i>Java 11:</i>	Llojet dhe karakteristikat e shtallave, ndarja e tyre
<i>Java 12:</i>	Tipologjia e stallave klasike
<i>Java 13:</i>	Tipologjia e stallave të lira
<i>Java 14:</i>	Elementet e projektimit të fermave
<i>Java 15:</i>	Rikapitulumimi i kursit

### Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Marrja e kredive bëhet me verifikimin e prezencës dhe aktivitetit në ligjërata dhe ushtrime, me projektin semestral të vlerësuar pozitivisht si dhe vlerësimin me shkrim të vlerësuar pozitivisht.

**Shënim |** Të drejtë të hyrjes në provim në lëndën **PROJEKTIM 7 – FERMAT VERTIKALE**, kanë vetëm studentët të cilëve elaborati semestral u vlerësohet me notë pozitive si dhe të cilët nuk kanë më shumë se tre mungesa të arsyeshme/të paarsyeshme në ligjërata ose ushtrime.